



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:078609

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05484003

C.nr.283/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.. me seli në Prishtinë, rr. .. të cilën e përfaqëson Kompania “V.., me autorizim F. L., kundër të paditurit A. M. nga fshati .. Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 884.00 euro, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M  
NË BAZË TË POHIMIT

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.. me seli në Prishtinë, rruga ...

II. DETYROET i padituri A.M nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 07.12.2013, t’ia paguajë paditëses B.. shumën prej 884.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja B.. me seli në Prishtinë, rr. .., përmes të autorizuarës së saj, me datë 19.06.2017, ka paraqitur padi kundër të paditurit A.M nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, për rimbursim të dëmit në shumën prej 615.00 euro, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 07.12.2013, në fshatin .. Komuna e Vushtrrisë, me ç ’rast dëme materiale pëson familja A. nga Vushtria. Ka shtuar se në procedurë jashtëgjyqësore të dëmtuarit familja A. nga Vushtria, i është kompensuar dëmi material dhe jo material i pësuar si rezultat i aksidentit. Andaj bazuar në këto arsye ka

kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurin A.M t'ia rimburoj dëmit të shkaktuar në shumën prej 615.00 euro, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar si dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësja B., po ashtu me datë 26.10.2017, ka paraqitur padi kundëer të paditurit A.M, për rimbursim të dëmit në shumën prej 269.00 euro, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 07.12.2013, në fshatin .. Komuna e Vushtrrisë, me ç' rast dëme në automjet ka pësuar F.A nga Vushtrria. Ka shtuar se në procedurë jashtëgjyqësore të dëmtuarit F.A, i është kompensuar dëmi material për dëmtimin e autmmjetit, i pësuar si rezultat i aksidentit. Andaj bazuar në këto arsye ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurin A.M t'ia rimburoj dëmit të shkaktuar në shumën prej 269.00 euro, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata me datë 05.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën përfaqësuesi i paditëses ka mbetur pranë padive të parashtruara, duke kërkuar nga gjykata që padinë ta aprovojë si të bazuar, dhe të obligohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material, ta paguajë shumën prej 884 euro, po ashtu i ka ofruar mundësinë të paditurit për arritjen e marrëveshjes gjyqësore, ashtu që i padituri të paguaj shumën detyrimin e tij në 16 këste mujore, përkatësisht shumën e kështit mujor prej 55.25 euro.

I padituri A.M, nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses për rimbursimin e dëmit material dhe jo material, duke shtuar se sipas raportit policor konstatohet që është shkaktar i aksidentit. E ka njoftuar gjykatën se nuk ka mundësi që përnjëherë ta paguaj shumën prej 884 euro siç kërkon paditësja, pasi është i pa punë, rast social, baba i pesë fëmijëve dhe nuk ka të hyra të tjera për ta mbajtur familjen përveç ndihmës sociale në shumën prej 180 euro në muaj. Sa i përket ofertës së dhënë nga përfaqësuesi i paditëses për arritjen e marrëveshjes gjyqësore, për të paguar shumën në 16 këste, në shumën prej 55.25 euro, ka kërkuar nga gjykata një afat shtesë në mënyrë që të deklarohet për arritjen e marrëveshjes gjyqësore.

Gjykata me datë 15.03.2024, ka mbajtur seancën e radhës në të cilën përfaqësuesi i paditëses i ka ofruar mundësinë të paditurit që shumën prej 884.00 euro ta paguaj në 24 këste mujore dhe meqenëse ndaj të paditurit të njëjtë janë paraqitur dy padi që lidhen me aksidentin e njëjtë, gjykatës i ka propozuar që të bëjë bashkimin e tyre dhe të vazhdohet me një procedurë.

I padituri ka mbetur pranë deklarimeve të mëparshme, ndërsa sa i përket propozimit të përfaqësuesit të paditëses që detyrimin ndaj tyre në shumën prej 884 euro, ta paguaj në 24 këste,

ka theksuar se nuk mund ta paguaj për 24 këste, pasi që kur llogaritet shuma prej 884 me 24 këste, i bie që të paguaj 36.83 euro në muaj, por mund ta paguaj shumën prej 20 euro në muaj. Sa i përket propozimit të përfaqësuesit të paditëses për bashkimin e lëndëve, është pajtuar që këto dy lëndë të bashkohen në një lëndë të vetme dhe për të njëjtat të merret një vendim.

Gjykata ka bërë bashkimin e lëndëve kontestimore C.nr.283/17 dhe C.nr.505/17, sipas padisë së paditëses B.. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit A.M nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, ashtu që lëndët e bashkuara janë evidentuar në numrin C.nr.283/17.

Gjykata në bazë të lartcekurave e duke marrë parasysh se kërkesëpadia e paditësit është pohuar nga i padituri, bazuar në nenin 148 par 1 dhe 2 të LPK-së ku përcaktohet se “Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

Gjykata në kuptim të nenit 148.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pas pohimit të kërkesëpadiës nga i padituri, ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat i referohen shpenzimeve për taksën gjyqësore për padi në shumën prej 30 euro.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.283/17, me datë 21.03.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.